



INTERNATIONAL INSTITUTE FOR PRIVATE
COMMERCIAL AND COMPETITION LAW
(IIPCC)



INSTITUT ZA NAUČNA ISTRAŽIVANJA I RAZVOJ
INSTITUTI PER KËRKIMET SHKENCORE DHE ZHVILLIM
INSTITUTE FOR SCIENTIFIC RESEARCH AND DEVELOPMENT
ULCINJ-ULCIN

Registarski broj: MOC-0813; Matični broj: 02910977



Book of proceedings

4-th ICBLAS

Vol. 2

**Fourth International Conference on:
"Business, law, administration and social
sciences - Challenges towards the future 2016"**

1 October, 2016

Tirana-Bialystok (Poland)

Edited by: Prof. assoc. Dr (PhD Uni Graz)

Endri Papajorgji

© All rights reserved. No part of this publication may be reproduced, stored in a retrieval system, or transmitted in any form or by any means, electronic, mechanical, photocopying, recording or otherwise, without either the prior written emission of the publisher. Applications for the copyright holder s written permission to reproduce any part of this publication should be addressed to the publishers.

Book of Proceedings of Fourth International Conference on:
“Business, law, administration and social sciences - Challenges towards the future 2016”

Editor: E. Papajorgji

Tirana - Bialystok

ISBN: 978-9928-214-35-5

Disclaimer

Every reasonable effort has been made to ensure that the material in this book is true, correct, complete, and appropriate at the time of writing. Nevertheless the publishers, the editors and the authors do not accept responsibility for any omission or error, or any injury, damage, loss or financial consequences arising from the use of the book. The views expressed by contributors do not necessarily reflect those of University of Bialystok (Poland), International Institute for Private, Commercial and Competition law, Institut za naučna istraživanja (Montenegro), Tirana Business University (Albania) and University College Pjeter Budi of Pristina, (Kosovo).

Nga Peace Research në Peace Economics: roli i procesit të integritit Europjan

Dr. Romina Gurashi
Universiteti "Sapienza" i Romes

Abstrakt

Menjehere mbas viteve te luftes se dyte boterore, studimet mbi paqen dhe mbrojtjen nga konfliktet e ndryshme, jane berë perhere e më të rendsishme duke arritur në një ndryshim rrenjesor të paradigmave në vitet '70. Vemendja e studiuesve u perqendru në konceptin "paqe" (negative) jo më si ekuilibër internacionale diametralisht i kundërt me gjendjen e luftes por si raport që ka të bejnë me "mungesën e dhunës" (structurale o kulturele). Nje paqe e ndertuar vetëm nepermjet ndryshimit rrenjesor të shoqerisë, të zhvillimit politik e ekonomik, si dhe zhdukjes se pabarazinave.

Ne brendesi te ketij projekti që permbledh shumë fusha studimi ne te cilin ishte e rendsishme krijimi i nje shoqerije te re në sferën politike, ekonomike e kulturele perfshihet edhe një mendim i ri mbi ate te quajturën "Peace Economics". Çfare do te thotë: "Peace Economics"? Duke perdorur thenjet e Jurgen Brauer dhe ato të Raul Caruso mund te themi që ajo përfshin studimin ekonomik, projektimin dhe themelimin e nocjoneve kryesore dhe institucionet perkate politike, ekonomike dhe kulturele; bashkëveprimi i tyre, dhe politikat per të parandaluar, lehtësuar o zgjidhjen e çdo lloj violence aktuale, dhe fshehur, o konflikte të tjera shkaterruese brenda shoqerive ose mes shoqerive te ndryeshme".

Cilat jane krakteristikat e Peace Economics? Dhe çfare lidhje egziston mes Peace Economics dhe procesit te integritit europjan? Ky përpunim do te tregojë se fillimi i këtij studimi i ka rrenjet në procesin e integritit që ka sjelle krijimin e instituteve europjane. Mund te themi që zhvillimi i njerës ka ndihmuar e kondicionuar zhvillimin e tjetres dhe gjithashtu në te kundert.

Shembulli dhe historia e komunitetit europjan (Europes se bashkuar) dëshmojnë qe bashkpunimi dhe integrimi politik, ekonomik shoqeror kan qenë elemente të domodoshme te nje politike qe ka ndyshuar fetyuren e botes.

Fjalë kyçe: Peace Research, Peace Economics, Integrimi Europjan, Peace Research Society (International), International Peace Association.

Nje histori e shkurte per Peace Research e revolucioni teorik ne vitet 70^{te}

Duke miratuar tezat e Norberto Bobbio, qysh në periudhen mbas Luftës se Dyte Boterore ishte e mundur që te gjindeshin levizjet e para në studimet shkencore për paqen te perfshira në te quajteren "*polemologie*", nje degë e teorisë së relacjoneve internacionale e cila kishte si qellim kryesor te kuptonte konfliktet, origjinen e tyre dhe funksionimin e tyre. Mund të thuej që ishte "studimi i luftës dhe i fenomeneve që e shoqerojnë, nga pikepamja ushtarake e shoqerore-politike"(Bobbio, Matteucci & Pasquino 2004).

Vetëm mbas Luftës se Dyte Boterore, studimet per paqen (Peace Studies) behen nje rrugë studimeve të pavarura, edhe pse qysh në periudhen në mes te Luftës se Pare dhe te Dyte Boterore, Sorokin, Richardson e Wright kishin identifikuar dhe kishin shprehur nevojen e krijimit, zhvillimit e zbatimit te nje metode shkencore per studimet mbi pacen.

Duke u kthyer në fund të Luftes së Dytë Botërore, veme re që, me shumë se asnjehere tjetër, ndihet nevoja për paqe. Në kampin e sudimeve shkencore, me një kembe ngulje në ritje, vëmendja përqendrohet mbi problemin e çarmatosjes dhe mbi rrezikun që paraqesin përparimet e studimeve shkencore për qellimet ushtarake. Interes i madh i kushtohet edhe një aspekti tjetër: bashkëpunimi mes shteteve. Zhvillohen në këto drejtim teorite e paçifizmit institucjonal (ose juridik) që të mbajnë monopolizimin e ligjeshëm të dhunës (Bobbio 2009).

Rrënjët e kësaj egzigence për të gjetur pacen janë si përgjigje e frikës të një lufte nukleare dhe në përpjekjet për të evituar konfliktet shkatruese për njerëzimin. Lufta e Ftohtë dhe ekuilibri i terrorit paraqesin në këto mënyre arsye për egzistencën e Peace Research dhe të studimeve kryesore që kanë të bëjnë me problemin e “çarmatosjes”, të Conflict Theory dhe Conflict Analysis.

Që në këto momente Peace Studies karakterizohen nga hyrja në sferën e shkencave shoqërore duke bërë kërkime mbi konfliktet në botën reale dhe zgjidhjen e tyre.

Për këto arsye, qysh në fillim, aspekti teorik ka marrë menjehere vlerë si instrumentale edhe i brendshme sepse studjuesit shkencorë lidh çdo konflikt me modelin apo procesin shoqëror që siç dihet përfshin shumë aspekte të përgjithshme, komplekse dhe integruese.

Në fundet e viteve '50 e deri në vitet '70, vihet re një rritje sasinë dhe kompleksitetin e temave të trajtuara. Në këto periudhë, zhvillimi i kërkimeve shkencore është i drejtuar në veçanti në përpunimin e modeleve e metodave të reja. Në veçanti në zbatimet që lidhen me modelet ekonomike, teorija e bojrave, aplikimet experimentuese, në sociologji, etj. Gjithashtu behën përpjekje për të përfshirë studjuesit të sferave të tjera për të pasuruar kërkimet shkencore me ndjohuri, perspektiva të reja. Për shembull, teoria e loirave përpunuar nga Neumann, e përdorur nga psikologët, si Rapoport, aplikohet në teorite të konfliktit duke u bërë një nga shtydhjat kryesore të teorisë mbi konfliktet.

Duke levizur në shumë fusha dhe në zhvillim të përherëshëm, studiuesit shpesh here janë të detyruar të përpunojnë e përcaktojnë sferën përkatëse të studimeve.

Megjithatë, Peace Research mbetet një argument që zhvillohet në veçanti në Amerikën e Veriut dhe Europën Perëndimore.

Fenomenet internacionale që nga fillimi e deri në fund të viteve gjashtedhjetë, nga kriza kubane deri në pushtimin e Çekosllovakisë paraqesin një seri pyetjesh në brendësi të Peace Research, të lidhura kryesisht me rreziqet e luftes së ftohtë, mekanizmin e sundimit e shfrytëzimit të rolit të disiplinës në disa konflikte.

Nga viti 1968 deri në 1969, në brendësi të Konferencës së Peace Research Society mbi Vietnamin dhe në Konferencën Europjane të Peace Research Society (International) të Kopenhagenit, krijohen dy rrymatë të ndryshme (Asbjørn Eide 1972).

Konferenca e 6^{te} Europjane të Peace Research Society e mbajtur në '69 paraqet momentin më të lartë të kundërshtimeve mes këtyre dy rrymave; një deklaratë kundër Peace Research tradicionale firmoset nga pjesa më e madhe e studjuesve shkencorë që ishin prezent.

Në përgjithësi, thuhej që levizja e Peace Research po degjeneronte në disa fraksione që u krijua mes Peace Researcher “radikali” dhe “tradicionali” paraqiti një moment fundamental në procesin e pjekurisë të këtyre studimeve. Nga viti 1968 deri 1969 konteksti politik kishte ndryshuar në mënyrë të ndjeshme në krahasim me atë menjehere mbas Luftes së Dytë Botërore. Lufta e ftohtë ishte zbutë në mënyrë të kon-

siderueshe, rreziku i nje lufte nukleare mendohej si nje dicka jo e mundshme dhe aspektet negative të lidhura me sundimin e superfuqive behen përhershme e me te dukshme në zonat e tyre te influencës. Perpjekjet e Shteteve te Bashkuara per te mbajtur nen kontroll Indo-Kina duke perdorur mjetet ushtarake eshte deshmi dramatike për sa me siper. Nga ana tjetër Bashkimi Sovietik, me pushtimi e Çekoslovakise tregoj kembenguljen e saj në perdorimin e forces per parandalimin e çfaredolloj levizje që kercentote sigurin e intereseve te Bashkimit Sovjetik.

Edhe pse tensionet mbes dy superfuqive po zvogeloheshin, armatimi vazhdonte. Kjo vë në dukje që problemi kryesor nuk perfaqesohej jo vetem nga konfliktet mes shtetet më të vogla dhe grupe te tjere me shtetet më të vogla dhe grupe te tjera terriorjale.

Keshtu Peace Research vihet në diskutime në bazë te 5 pikave kryesore:

- 1) Mungesa e aftesive per te zbuluar argumente te rendesishme;
- 2) Per te kontributin e saj në mistifikimin e realitetit nepermjet zbulimeve te pa rendësishme;
- 3) Per shkak te perdorimit te nje koncepti për paqe shume te kufizuar, te thjeshtuar, dhe nje koncept mbi konfliktin te shtremberuar e shumë te papershtatëshem;
- 4) Thuhej gjithashtu që ket koncepte janë rrjedhoje e “kembënguljeve” iedologjike dhe rezultonte e pamundur dalja nga keto kanale;
- 5) Thuhej gjithashtu që Peace Researcher ndihmonin elitat sunduese te botës në vazhdimin e sundimit në zonat e tyre rispektive te influencave.

Ne kete quader, vitet '70, paraqiten kushtet në te cilat nje qendrim me i pjekur e më polieder, per kete materie, po zhvillohej. Keshtu shenohet hyrja në nje fazë të re te zhvilimit te stuimeve për paqen në te cilen koncepte mbi paqen dhe konfliktet vihen në diskutim.

Persa i perket konceptit mbi konfliktin kalohet nga nje menyre veshtimi në te cilen aktoret jane “në lufte me njeri tjetrin për te arritur në rezultate te ndryshme që nuk perputhen me njeritjetrin” - një vizion simetrike, subjektive dhe e orientuar drejt aktori – ne nje tjetër, më objektive që konsideronte konfliktin si nje mungese harmonie te interesave mes grupeve (klasave, shteteve, etj) te ndryshme. Keshtu konflikti konsiderohet “embeded” ne strukturën shoqeroree në proceset e saja. Ai është realitet si në rastin që aktoret janë te ndergjegjeshëm ose jo dhe si ne rstin kur nuk egziston nje qendrim konfliktual siç ndoll në rastet e veprimeve me dhune. Gjithashtu, duke qene i rrenjosur ne strukturat shoqerore nuk i perket me vetëm sferave te rapoteve internacionale dhe sferave te raporteve shoqerore.

Për sa i perket konceptet te paqes, per peace researcher tradicionalista ajo ka te bej me zhdukjen e dhunes fizike në nje shoqeri (lokale, rajonale, nacionale boterore)ku nuk egzistojne divergjenza dhe bashkepunimi është i mbeshtetur në barazimin mes grupeve te ndryshme. Ne këtë mënyre, paqja nuk eshte më nje diçka që duhet te mbahet si eshte, por eshte diçka që duhet te krijohet e risistemohet. Si krijohet? Nëpermjet zhdukjes se strukturave hierarkike, te pabarabarta e shtypëse. Mbitegjithe nepermjet zhvillimit te vazhdueshëm te modeleve te bashkëpunimit në menyre horizontale që shperblen në menyre të barabarte te gjithë pjesëmarrësit.

Idea e pare mbi paqen ka qene e percaktuar si paqe negative sepse percaktonte në menyre konsideruar paqen si mungese te dhunës fizike. Ne kete menyre viheshin kufit mjetet e perdrur nga aktoret per te arritur qellimin. Idea e dyte mbi paqen pershkruhet në menyre positive dhe jep spjegjim te konceptit duke treguar cilat duke

te jene objektivet perfundimtare që duhet të drejtojnë bashkepunimin shoqëror. Kjo ide nuk kufizohet vetëm në mjetet e përdorur nga autorët por vë në qendër të kerkimeve të saja relacionet mes autoreve. Në këtë mënyrë behet e parandueshme që përpjekjet për krijimin e raportave të barabartë të kalojnë nepermjet dhunës fizike si në rastin e revolucioneve ma dhunë.

Behet fjale për një paqe që kërkon një ndryshim rrenjesor shoqëror; zhvillimi politik e ekonomik dhe zhdukjen e pabarazirave (Galtung & Fischer, 2013).

Vitet '70 paraqesin kështu një periudhë të një ndryshimi të fortë nga pikëpamja filozofike. U zhvillua një levizje si me qenë një revolucion Kopernikan që bëri të mundur shumë diskutime mbi këtë argument. Për këtë arsye vitet '70 ishin vitet në të cilat u rritën shumë numri i institutëve të studiimit të studimeve shkencore mbi paqen. PRIO, instituti më i rëndësishëm në studimet mbi paqen lindi në '59. Në vitin '73 lindi Peace Science Society (Internacionale), në '64 International Peace Research Association, në 1966 SIPRI etj.

Gjithashtu, në këto vite, rriten në mënyrë të ndryshme edhe mendimet e ndryshme brenda kësaj disipline. Në veçantë, zhvillohen një seri degesh. Në brendësi të këtyre degëve egzistojnë mënyra të ndryshme, perspektiva dhe drejtime të ndryshme të cilat kanë bërë të mundur zhvillimin dhe zhjerimin e fushave të cilat bëjnë të mundur që të gjyken problemet shoqërore të gjejnë vend të ndryshëm në Peace Research.

Në këtë rrugë të ndryshmeve rrenjesore, sot Peace Research bën përpjekje mbi relacionet internacionale e nevojshme për parandalimin, lehtësimin dhe zgjidhjen e konflikteve që përdorin dhunën. Ky problem është me shumë rëndësi në qoftë se marrim parasysh problemet e krijuara nga ekonomia e bashkuar, nga të drejtat internacionale dhe sigurimi kombëtar. Duke parë këtë temë kuptojmë sa të shumta janë ato.

Është interesante studimi dhe spjegimi i dhënë nga një grup studiuesish të specializuar të Peace Research që quajnë Peace Economics ndertimin e konceptit të paqes duke u mbështetur në perspektivën ekonomike dhe në lëndën që – në fjalët e Weede – problemet e zhvillimit ekonomik e mireqenies, të lirise dhe rregullit shoqëror, të leacioneve internacionale e luftës janë të lidhura ngushtë me njëri tjetrin.

Interesante in tal senso è l'apporto dato da una branca specializzata della Peace Research, la Peace Economics, che viene intesa come progettazione della pace da una prospettiva economica nella convinzione che, - usando le parole di Weede - i problemi dello sviluppo economico e della prosperità, dell'ordine sociale e della libertà, delle relazioni internazionali e della guerra siano strettamente interdipendenti.

Peace Economics

Çfarë është Peace Economics? Duke përdorur thenjë të Jürgen Brauer dhe Raul Caruso mund të themi që ajo "përfshin studimet ekonomike dhe projektimin e institutëve politike, ekonomike dhe kulturore, si dhe edhe raportet mbështetëse, politikën dhe projektimin, lehtësimin dhe zgjidhjen e çdo lloji të dhunës aktuale, të fshehtë ose veprimeve të tjera të këqija me dhunë brenda shoqërisë dhe mes shoqërive të ndryshme" (Brauer & Caruso 2013, 151).

Behet fjale për të mbushur një boshllëk fenomenologjik, me zbatime epistemologjike, shkencore e kulturore në projektimin e paqes nga pikëpamja ekonomike. Peace Economics, në të vërtetë, zgjeron studimet përtej sferës ekonomike duke studiuar edhe argumentat që kanë të bëjnë me rindertimin e shoqërisë, kontratave shoqërore dhe të

kapitalit shoqëror me shprese që të furnizojnë mjetet me të pershtateshme që të bëjë sa më të qendrueshme paqen.

Kjo është një studim i drejtuar në mënyrë të veçantë për vendet që vuajnë për presencën e dhunës, si edhe vendet që po dalin nga lufta, nga konfliktet e brendshme – vende të cilat manifestojnë mungesë të ekuilibrit shtetëror, ekonomik, presencën e krimeve të organizuara dhe terrorizmit, etj.

Roli i procesit të integritit Europjan

Atehere perse të flasim për Peace Economics në këtë kontekst? Aresyja mbështetet në faktin që origjina e ketyre sudimeve reflekton fenomenologjitë të rrenjosura gjatë historisë së integritit europjan dhe të lindjes së institucioneve europjane. Egziston një lidhje e fortë – të paktën imagjinare) ndërmjet këtyre tipeve të eksperiencave dhe shpesh herë zhvillimi i nieres kushtëzohet zhvillimin e tjetres.

Disa tapa kryesore të procesit i cili ka sjellë lindjen e Komunitetit Europjan janë të rëndësishme për të spjeguar sa më siper. Para se fillonte procesi i integritit, John Maynard Keynes ka shkruar një veper me titull: “The economic consequences of the peace” e cila publikohet në vitin 1919, në fazën e perfundimit të traktatit të Versailles. Në këtë libër, ekonomisti i njohur anglez denonte Francën dhe Anglinë që i jepnin Germanisë një denim të vështirë për tu përballuar si nga ana shoqërore ashtu dhe financiare sepse ishte i bindur që pozicione kaq të egra mund të sillin prishjen e ekuilibrit dhe shpërthimin e një lufte të re (Keynes 1920, Preface).

Historia në fakt i ka dhënë të drejtë.

Në fundin e Luftës së Dytë Botërore, linja e denimit deri në eliminimin e armikut propozohet përsëri; por kondicionimi i krijuar prej mendimit të Winston Churchill – i cili mendonte që vetëm një Europë e bashkuar mund të sigurojë një paqe duke shkatërruar idetë nacionaliste e ushtarake – dhe prej frikës që një Germanjë me një ekonomi në rritje mund të vendoste që llidhjet me perëndimin ose të përfshihej në në Baskimin Sovjetik, shtynë Presidenti Amerikan Truman dhe Sekretari i Shtetit Marshall për të filluar Marshall Plan (1948-1952), një plan ndihimesh ekonomike i cili kishte si qëllim që të ndihmonte zhvillimin e shteteve europjane të cilat dalen të demtuar nga Luftës së Dytë Botërore (Eichengreen 2008). Në këtë mënyrë filloj një tipi i çuditshëm i Peace Economics.

Në itinerarin e shënuar nga Keynes e Marshall, u bashkuan edhe Jan Monnet e Robert Schuman (Schumann 2011), baballarët e Europës së Bashkuar. Planet e tyre ishin të lidhura for me idetë që një bashkim ekonomik i shteteve europjane pengonte krijimin e konflikteve të reja mes shteteve që benën pjesë në këtë bashkim. Duke ndimuar kundërshtarët e luftës të sapo mbaruar, ato benën të mundur të shuanin fyerjet mes tyre, propozuan bashkëpunimin mes tyre për të arritur se bashkim në ushtrimin e rolit shekullor të cilin asnjëherë nuk mund të arrinte vetem tashti.

Historija e integritit është e njohur nga të gjithë. Raportet e reja mes shteteve pjesëmarrëse, të krijuar në fillim në Komunitetin Europjan të Karbonit dhe Hekurit (CECA), pastaj ato të në Komuniteti Europjan (CE) dhe tashi në Bashkimin Europjan (UE) shanojnë fillimin e një procesit të ndërtimit të bashkimit të kontinentit Europjan i cili është rritur e forcuar në pesëdhjetë vitet e fundit.

Integriti Europjan dhe me pas Bashkimi Europjan, temelohen e bazohen në vlerat e respektit, dinjitetit, njerzorisë, të lirisë, demokracisë, të barazisë, të shtetit ligjor, të dre-

jteva njerëzore duke përfshirë të drejtat e personave që bëjnë pjesë në minorancat (minoritete).

Behet fjale për vlera të një shoqëri që karakterizohet nga pluralizmi, nga mungesa e diskriminimeve, nga toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave e burrave dhe në veçantë bëhet fjalë për vlera të cilat i kanë rrënjët në vullnetin për të aplikuar paqen dhe mbarësinë mes popujve. Ku impenjim nuk ka të bëjë vetëm me raportet brenda kufijve të Bashimit Europian por edhe me raportet me pjesën tjetër të botës.

Nga këto pak referime historike duke e qartë (kyartë) çfarë roli ka luajtur projekti evropian në fillimin e studimeve mbi Peace Economics dhe çfarë roli kanë pasur studimet bi paqen në procesin e integritit evropian.

Bibliografi

Brauer J. & Caruso R. (2013), *Economists and Peacebuilding*, in R. Mac Ginty, Routledge Handbook of Peacebuilding, London, 2013.

Bobbio N., Matteucci N. & Pasquino G. (2004), *Dizionario di Politica*, Utet, Torino.

Bobbio N. (2009), *Il problema della guerra e le vie per la pace*, Il Mulino, Bologna.

Eichengreen B. (2008), *The European Economy since 1945: Coordinated Capitalism and Beyond*, Princeton University Press.

Eide A. (1972), *Dialogue and Confrontation in Europe*, *The Journal of Conflict Resolution*, Vol. 16, No. 4, *Peace Research in Transition: A Symposium*.

Galtung J. & Fischer D. (2013), *Positive and Negative Peace*, *SpringerBriefs on Pioneers in Science and Practice*, Volume 5, Berlin, 2013.

Keynes J. M., *The economic consequences of the Peace*, Mcmillan, London, 1920.

Schumann R. (2011), "Declaration of 9th May 1950", *European Issue* No. 204.